

*Zëvendësministrat*

## Dokumente të KM-së

CM(2014)20 finale 9 korrik 2014

---

### Takimi 1205, 9 korrik 2014

8 Rinia dhe sporti

#### 8.1 Marrëveshje e Zgjeruar e Pjesshme mbi Sportin (EPAS)

Konventa e Këshillit të Europës mbi Manipulimin e Garave Sportive

---

##### Preambulë

Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës dhe nënshkruesit e tjerë të kësaj Konvente

Duke patur parasysh që qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij;

Duke patur parasysh Planin e Veprimit të Samitit të Tretë të Krerëve të Shteteve dhe Qeverive të Këshillit të Europës (Varshavë, 16 - 17 maj 2005), që rekomandon vazhdimin e aktiviteteve të Këshillit të Europës që shërbejnë si referencë në fushën e sportit;

Duke patur parasysh që është e nevojshme të zhvillohet më tej një kuadër i përbashkët europian dhe global për zhvillimin e sportit, bazuar në konceptet e demokracisë pluraliste, shtetit ligjor, të drejtave të njeriut dhe etikës sportive;

Të ndërgjegjshëm që çdo vend dhe çdo tip sporti në botë mund të ndikohet potencialisht nga manipulimi i garave sportive dhe duke theksuar që ky fenomen, si një kërcënim global për integritetin e sportit, kërkon një përgjigje globale e cila duhet të mbështetet gjithashtu nga Shtetet që nuk janë anëtarë të Këshillit të Europës;

Duke shprehur shqetësim në lidhje me përfshirjen e aktiviteteve kriminale dhe veçanërisht krimin e organizuar në manipulimin e garave sportive dhe në lidhje me natyrën e tij transnacionale;

Duke kujtuar Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (1950, ETS Nr. 5) dhe Protokollet e saj, Konventën Europiane për Dhunën Spektakolare dhe Sjelljet e Papranueshme në Ngjarjet Sportive dhe veçanërisht në Ndeshjet e Futbollit (1985, ETS Nr. 120), Konventën Anti-Doping (1989, ETS Nr. 135), Konventën e së Drejtës Penale për Korrupsionin (1999, ETS Nr. 173) dhe Konventën e Këshillit të Europës për Pastrimin, Kërkimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi dhe mbi Financimin e Terrorizmit (2005, CETS Nr. 198);

Duke kujtuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional (2000) dhe Protokollet e saj;

Duke kujtuar gjithashtu Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (2003);

Duke kujtuar rëndësinë e hetimit me efektivitet pa vonesa të panevojshme veprat penale brenda juridiksionit të tyre;

Duke kujtuar rolin kryesor që Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale (Interpol) luan në lehtësimin e bashkëpunimit të efektshëm ndërmjet autoriteteve të zbatimit të ligjit përveç bashkëpunimit gjyqësor;

Duke theksuar që organizatat sportive kanë përgjegjësinë për të zbuluar dhe sanksionuar manipulimin e garave sportive të kryera nga persona nën autoritetin e tyre;



Duke njohur rezultatet tashmë të njohura në luftën kundër manipulimit të garave sportive;

Të bindur që një luftë e efektshme kundër manipulimit të garave sportive kërkon bashkëpunim kombëtar dhe ndërkombëtar të shtuar, të shpejtë, të qëndrueshëm dhe funksional;

Duke patur parasysh Rekomandimet e Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare Rec(92)13rev mbi Kartën e rishikuar Europiane për Sportet, CM/Rec(2010)9 mbi Kodin e rishikuar të Etikës Sportive; Rec(2005)8 mbi parimet e qeverisjes së mirë në sport dhe CM/Rec(2011)10 mbi nxitjen e integritetit në sport për të luftuar manipulimin e rezultateve, veçanërisht fiksimin e ndeshjeve;

Në dritën e punës dhe konkluzioneve të konferencave të mëposhtme:

- Konferencës së 11-të të Ministrave përgjegjës për Sportin të Këshillit të Europës, të mbajtur në Athinë më 11 dhe 12 dhjetor 2009;
- Konferencës së 18-të Informale të Ministrave përgjegjës për Sportin të Këshillit të Europës (Baku, 22 shtator 2010) mbi nxitjen e integritetit të sportit kundër manipulimit të rezultateve (fiksimi i ndeshjeve)
- Konferencës së 12-të të Ministrave përgjegjës për Sportin të Këshillit të Europës, (Beograd, 15 mars 2012) veçanërisht në lidhje me hartimin e një instrumenti të ri ligjor ndërkombëtar kundër manipulimit të rezultateve sportive;
- Konferencës së 5-të Ministrave dhe Nëpunësve të Lartë përgjegjës për Edukimin Fizik dhe Sportin të UNESCO-s (MINEPS V);

Të bindur që dialogu dhe bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve publike, organizatave sportive, organizatorëve të garave dhe operatorëve të basteve sportive në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare mbi bazën e respektit dhe besimin reciprok janë thelbësore në kërkim të përgjigjeve të përbashkëta të efektshme ndaj sfidave që ngrihen nga problemi i manipulimit të garave sportive;

Duke njohur që sporti, bazuar në garën e ndershme dhe të barabartë, është i paparashikueshëm në natyrë dhe kërkon kundërvënien me forcë dhe efektivitet ndaj praktikave dhe sjelljes joetike në sport;

Duke theksuar besimin e tyre që zbatimi i qëndrueshëm i parimeve të qeverisjes së mirë dhe etikës në sport është një faktor i konsiderueshëm në ndihmën për çrënjosjen e korrupsionit, manipulimit të garave sportive dhe llojeve të tjera të praktikave të papranueshme në sport;

Duke njohur që, në pajtim me parimin e autonomisë së sportit, organizatat sportive janë përgjegjëse për sportin dhe kanë përgjegjësi vetë-rregulluese dhe disiplinore në luftën kundër manipulimit të garave sportive, por që autoritetet publike mbrojnë integritetin e sportit, sipas rastit;

Duke njohur që zhvillimi i aktiviteteve të basteve sportive, veçanërisht e basteve të paligjshme sportive, rrit riskun e këtij manipulimi;

Duke patur parasysh që manipulimi i garave sportive mund të lidhen ose jo me bastet sportive dhe lidhen ose jo me veprat penale dhe që duhet të trajtohet në të gjitha rastet;

Duke patur në vëmendje marzhin e diskrecionit që gëzon çdo Shtet brenda kuadrit të ligjit të zbatueshëm, në marrjen e vendimit mbi politikat e basteve sportive,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

## **Kapitulli I - Qëllimi, parimet drejtuese, përkufizimet**

### **Neni 1 - Qëllimi dhe objektivat kryesore**

1. Qëllimi i kësaj Konventë është lufta kundër manipulimit të garave sportive me qëllim mbrojtjen e integritetit të sportit dhe etikës sportive në pajtim me parimin e autonomisë në sport.

2. Për këtë qëllim, objektivat kryesore të kësaj Konvente janë:

- a. parandalimi, zbulimi dhe sanksionimi i manipulimit kombëtar dhe transnacional i garave sportive kombëtare dhe ndërkombëtare;
- b. nxitja e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar ndaj manipulimit të garave sportive ndërmjet autoriteteve publike përkatëse, si dhe me organizatat e përfshira në sporte dhe bastet sportive.

## Neni 2 - Parimet Udhëzuese

1. Lufta kundër manipulimit të garave sportive garanton respektimin, ndërmjet të tjerësh, për parimet e mëposhtme:
  - a. të drejtat e njeriut;
  - b. ligjshmërinë;
  - c. proporcionalitetin;
  - d. mbrojtjen e jetës private dhe të dhënave personale.

## Neni 3 - Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Konvente:

1. "Garë sportive" është çdo aktivitet sportiv i organizuar në pajtim me rregullat e caktuara nga një organizatë sportive i renditur nga Komiteti për Ndjekjen e Konventës në pajtim me Nenin 31.2 dhe të njohur nga një organizatë ndërkombëtare sportive, ose, sipas rastit, një organizatë tjetër kompetente për sportet.
2. "Organizatë sportive" është çdo organizatë që rregullon sportin ose një sport të caktuar dhe që shfaqet në listën e miratuar nga Komiteti për Ndjekjen e Konventës në pajtim me Nenin 31.2, si dhe organizatat e saj filiale kontinentale ose kombëtare, sipas rastit.
3. "Organizatorë të garave" është çdo organizatë sportive ose një person tjetër, pavarësisht nga forma e tij ligjore, që organizon gara sportive.
4. "Manipulim i garave sportive" është një masë, veprim ose mosveprim i qëllimshëm që synon një ndryshim të papërshtatshëm të rezultatit ose rrjedhës së një gare sportive me synim heqjen e të gjithë ose një pjese të natyrë së paparashikueshme të garës së sipërpërmendur sportive me synim përfitim të një avantazhi të parregullt për vete ose për të tjerët.
5. "Baste sportive" është vendosja e një shume vlere monetare në pritje të një çmimi në vlerë monetare, të kushtëzuar nga një ndodhi e pasigurt në të ardhmen në lidhje me një garë sportive. Veçanërisht:
  - a. "baste sportive të paligjshme" janë të gjitha aktivitetet e basteve sportive tipi ose operatori i të cilëve nuk lejohet në bazë të ligjit të zbatueshëm ose juridiksionit ku konsumatori gjendet;
  - b. "baste sportive të parregullta" janë të gjitha aktivitetet e basteve sportive në mospërputhje me modelet e zakonshme ose të parashikuara të tregut në fjalë ose në lidhje me bastet në një garë sportive kryerja e të cilave ka karakteristika të pazakonshme;
  - c. "baste sportive të dyshimta" janë të gjitha aktivitetet e basteve sportiv të cilat, sipas provave të besueshme dhe të qarta, duken se lidhen me një manipulim të garës sportive për të cilin ofrohen.
6. "Aktor në garë" është çdo person fizik ose juridik që i përket një prej kategorive të mëposhtme:
  - a. "atlet" është një person ose grup personash, që marrin pjesë në gara sportive;
  - b. "personel mbështetës i atletit" është një trajner, menaxher, agjent, personel ekipi, zyrtar ekipi, personel mjekësor ose paramjekësor që punon ose trajton atletët që marrin pjesë ose që përgatiten për garat sportive, dhe të gjithë personat e tjerë që punojnë me atletët;
  - c. "zyrtar" është çdo person i cili është zotëruar ose aksioner, anëtar zbatues ose personeli i subjekteve që organizojnë dhe nxisin garat sportive, si dhe arbitrat, anëtarët e jurisë dhe çdo person tjetër i akredituar. Termi mbulon gjithashtu zbatuesit dhe personelin e organizatave sportive ndërkombëtare, ose sipas rastit, organizata të tjerë sportive kompetente që njohin garën.
7. "Informacion i brendshëm" është çdo informacion në lidhje me një garë që një person ka në sajë të pozicionit të tij ose të saj në lidhje me një sport ose garë, duke përjashtuar çdo informacion të publikuar ose të ditur, lehtësisht të aksesueshëm për anëtarët e interesuar të publikut ose të deklaruar në pajtim me rregullat dhe rregulloret që rregullojnë garat përkatëse.

## **Kapitulli II - Parandalimi, bashkëpunimi dhe masa të tjera**

### **Neni 4 - Bashkërendimi i brendshëm**

1. Secila palë bashkërendon politikat dhe veprimin e të gjithë autoriteteve publike të përfshira në luftën kundër manipulimit të garave sportive.
2. Brenda juridiksionit, secila Palë inkurajon organizatat sportive, organizatorët e garave dhe operatorët e basteve sportive të bashkëpunojnë në luftën kundër manipulimit të garave sportive dhe, sipas rastit, u beson atyre zbatimin e dispozitave përkatëse të kësaj Konvente.

### **Neni 5 - Vlerësimi dhe menaxhimi i riskut**

1. Secila Palë, sipas rastit në bashkëpunim me organizatat sportive, operatorët e basteve sportive, organizatorët e garave dhe organizatat e tjera përkatëse, identifikojnë, analizojnë dhe vlerësojnë risqet e shoqëruara me manipulimin e garave sportive.
2. Secila Palë inkurajon organizatat sportive, operatorët e basteve sportive, organizatorët e garave dhe çdo organizatë tjetër përkatëse për të vendosur procedura dhe rregulla me synim luftën kundër manipulimit të garave sportive dhe miraton, sipas rastit, masat legjislative ose të tjera të nevojshme për këtë qëllim.

### **Neni 6 - Edukimi dhe rritja e ndërgjegjësimit**

1. Secila Palë inkurajon rritjen e ndërgjegjësimit, edukimit, trajnimit dhe kërkimit për të fuqizuar luftën kundër manipulimit të garave sportive.

### **Neni 7 - Organizatat sportive dhe organizatorët e garave**

1. Secila Palë inkurajon organizatat sportive dhe organizatorët e garave për të miratuar dhe zbatuar rregullat për të luftuar kundër manipulimit të garave sportive si dhe parimet e qeverisjes së mirë, në lidhje, ndërmjet të tjerash, me:
  - a. parandalimin e konfliktit të interesave, duke përfshirë:
    - ndalimin e aktorëve të garave nga vënia e basteve në garat sportive në të cilat ata janë përfshirë;
    - ndalimin e keqpërdorimit ose shpërndarjen e informacionit të brendshëm;
  - b. përmbushjen nga organizatat sportive dhe anëtarët e tyre të të gjithë detyrimeve të tyre kontraktuale ose të tjera;
  - c. kërkesën që aktorët e garës të raportojnë menjëherë çdo aktivitet të dyshimtë, incident, shtysë ose qëndrim që do të konsiderohej një shkelje e rregullave ndaj manipulimit të garave sportive.
2. Secila Palë inkurajon organizatat sportive të miratojnë dhe zbatojnë masa të përshtatshme me qëllim që të garantojnë:
  - a. monitorim intensiv dhe të efektshëm të zhvillimit të garave sportive që janë të ekspozuara ndaj riskut të manipulimit;
  - b. masat për të raportuar pa vonesë rastet e aktiviteteve të dyshimta në lidhje me manipulimin e garave sportive tek autoritetet publike ose platformën sociale;
  - c. mekanizmat efektivë për të lehtësuar deklarin e çdo informacioni në lidhje me rastet e mundshme ose faktike të garave sportive, duke përfshirë mbrojtjen e përshtatshme për bilbil-fryrësit;
  - d. ndërgjegjësim tek aktorët e garave duke përfshirë atletët e rinj mbi riskun e manipulimit të garave sportive dhe përpjekjet për ta luftuar atë, nëpërmjet edukimit, trajnimit dhe shpërndarjes së informacionit;
  - e. caktimit të punonjësve përkatëse për garat sportive, veçanërisht gjyqtarët, në fazën më të vonshme të mundur.
3. Secila Palë inkurajon organizatat e saj sportive dhe nëpërmjet tyre organizatat sportive ndërkombëtare të zbatojnë sanksione dhe masa specifike, të efektshme proporcionale dhe detyruese disiplinore për shkeljet e rregullave të tyre të brendshme ndaj manipulimeve të garave sportive, veçanërisht ato që përmenden në paragrafin 1 të këtij Neni, si dhe për të siguruar njohjen dhe ekzekutimin reciprok të sanksioneve të vendosura nga organizatat e tjera sportive, veçanërisht në vendet e tjera.

4. Përgjegjësia disiplinore e vendosur nga organizatat sportive nuk përjashton asnjë përgjegjësi disiplinore, civile ose administrative.

### **Neni 8 - Masat në lidhje me financimin e organizatave sportive**

1. Secila Palë miraton ato masa legislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të siguruar transparencën e përshtatshme në lidhje me financimin e organizatave sportive që mbështeten financiarisht nga Pala.

2. Secila Palë konsideron mundësinë e ndihmës për organizatat sportive për të luftuar manipulimin e garave sportive, duke përfshirë financimin e mekanizmave të përshtatshëm.

3. Secila Palë sipas rastit shqyrton mosdhënien e mbështetjes financiare ose nxitjen e organizatave sportive për të mos dhënë mbështetjen financiare aktorëve të garave të sanksionuar për manipulimin e garave sportive, për kohëzgjatje e sanksionit.

4. Sipas rastit, secila Palë ndërmerr hapa për të mos dhënë një pjesë ose të gjithë mbështetjen financiare ose tjetër në lidhje me sportet për organizatat sportive që nuk zbatojnë me efektivitet rregulloret për luftën kundër manipulimit të garave sportive.

### **Neni 9 - Masat në lidhje me autoritetin rregullator të basteve dhe autoritetin ose autoritetet e tjerë përgjegjës**

1. Secila Palë identifikon një ose më shumë autoritete përgjegjës, të cilat në rendin juridik të Palës ngarkohen me zbatimin e rregullores për bastet sportive dhe me zbatimin e masave përkatëse për të luftuar manipulimin e garave sportive në lidhje me bastet sportive, duke përfshirë sipas rastit:

a. shkëmbimin e informacionit në kohën e duhur, me autoritetet e tjera përkatëse ose një platformë kombëtare për bastet sportive të paligjshme, të parregullta ose të dyshimta, si dhe shkeljet e rregullores që referohen ose vendosen në pajtim me këtë Konventë;

b. kufizimin e ofrimit të basteve sportive, pas konsultimeve me organizatat sportive kombëtare dhe operatorët e basteve sportive, veçanërisht duke përjashtuar garat sportive:

- që janë të destinuara për ata nën moshën 18 vjeç; ose

- ku kushtet organizative dhe/ose angazhimi në termat sportive janë të papërshtatshme;

c. dhënien paraprake të informacionit në lidhje me tipet dhe objektet e produkteve të basteve sportive për organizatorët e garave në mbështetje të përpjekjeve të tyre për të identifikuar dhe menaxhuar risqet e manipulimit sportiv brenda garave të tyre;

d. përdorimin sistematik në bastet sportive të mjeteve të pagesës që lejojnë që fluksi financiar mbi një prag të caktuar, të përcaktuar nga çdo Palë e veçantë, të gjurmohet, veçanërisht dërguesit, marrësit dhe shumat;

e. mekanizmat në bashkëpunim me dhe ndërmjet organizatave sportive dhe, sipas rastit, operatorët e basteve sportive, për të ndaluar aktorët e garave nga vënia e basteve në garat sportive që janë në shkelje të rregullave ose ligjit të zbatueshëm për sportet përkatëse;

f. pezullimin e vënies së basteve, sipas ligjit të brendshëm, për garat për të cilat është dhënë një paralajmërim i përshtatshëm.

2. Secila Palë i komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës emrin dhe adresat e autoritetit ose autoriteteve të identifikuar në pajtim me paragrafin 1 të këtij Neni.

### **Neni 10 - Operatorët e basteve sportive**

1. Secila Palë miraton ato masa legislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të parandaluar konfliktin e interesave dhe keqpërdorimin e informacionit të brendshëm nga personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në dhënien e produkteve të basteve sportive, veçanërisht nëpërmjet kufizimeve për:

a. personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në produktet e basteve sportive që vënë baste me produktet e tyre;

b. abuzimin me një pozicion si sponsor ose pronar i pjesëshëm i një organizate sportive për të lehtësuar manipulimin e një gare sportive ose keqpërdorur informacionin e brendshëm;

c. aktorët e garave që përfshihen në përpilimin e kuotave të basteve për garën në të cilën ata janë përfshirë;

d. çdo operator të basteve sportive që kontrollon një organizator ose aktor garash, si dhe çdo operator të basteve sportive që kontrollohet nga ky organizator ose aktor i garave, duke ofruar baste për garën në të cilën është përfshirë ku organizator ose aktor gare.

2. Secila Palë inkurajon operatorët e saj të basteve sportive, dhe nëpërmjet tyre organizatat ndërkombëtare të operatorëve të basteve sportive për të rritur ndërgjegjësimin e pronarëve dhe punonjësve të tyre për pasojat dhe luftën kundër manipulimit të garave sportive, nëpërmjet edukimit, trajnimit dhe shpërndarjes së informacionit.

3. Secila Palë miraton ato masa legislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të detyruar operatorët e basteve sportive për të raportuar bastet e parregullta ose të dyshimta pa vonesë tek autoriteti rregullator i basteve, autoriteti ose autoritetet e tjera përgjegjëse ose platformën kombëtare.

### **Neni 11 - Lufta kundër basteve sportive të paligjshme**

1. Me synim luftën kundër manipulimit të garave sportive, secila Palë gjen mjetet më të përshtatshme për të luftuar kundër operatorëve të basteve sportive të paligjshme dhe konsideron marrjen e masave në pajtim me ligjin e zbatueshëm të juridiksionit përkatës, si:

- a. mbyllja ose kufizimi i drejtpërdrejtë ose jo i aksesit tek operatorët e paligjshëm të basteve sportive në distancë, dhe mbyllja e operatorëve të paligjshëm të basteve sportive lokalë në juridiksionin e Palës;
- b. bllokimi i fluksit financiar ndërmjet operatorëve të paligjshëm të basteve sportive dhe konsumatorëve;
- c. ndalimi i reklamave për operatorët e paligjshëm të basteve sportive;
- d. ngritja e ndërgjegjes së konsumatorëve për risqet në lidhje me bastet sportive të paligjshme.

### **Kapitulli III - Shkëmbimi i informacionit**

#### **Neni 12 - Shkëmbimi i informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente publike, organizatave sportive dhe operatorëve të basteve sportive**

1. Pa cenuar Nenin 14, secila Palë lehtëson, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe në pajtim me ligjin e brendshëm të saj, shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve publike përkatëse, organizatave sportive, organizatorëve të garave, operatorëve të basteve sportive dhe platformave kombëtare. Veçanërisht, secila Palë merr përsipër të ngrejë mekanizma për dhënien e informacionit përkatës nëse ku informacion mund të ndihmojë në kryerjen e vlerësimit të riskut të përmendur në Nenin 5 dhe kryesisht dhënien paraprake të informacionit në lidhje me tipet dhe objektin e produkteve të basteve tek organizatorët e garave dhe në fillimin dhe kryerjen e hetimeve ose procedimeve në lidhje me manipulimin e garave sportive.

2. Me kërkesë, marrësi i këtij informacioni, në pajtim me ligjin e brendshëm dhe pa vonesë, informon organizatën ose autoritetin që jep informacionit mbi masat pasuese pas këtij komunikimi.

3. Secila Palë shqyrton mënyra të mundshme për zhvillimin ose zgjerimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit në kontekstin e luftës kundër basteve të paligjshme sportive sipas parashikimit në Nenin 11 të kësaj Konvente.

#### **Neni 13 - Platforma kombëtare**

1. Secila Palë identifikon një platformë kombëtare që trajton manipulimin e garave sportive. Platforma kombëtare, në pajtim me ligjin e brendshëm, *ndër të tjera*:

- a. shërben si qendër informacioni, duke mbledhur dhe shpërndarë informacion që ka të bëjë me luftën kundër manipulimit të garave sportive tek organizatat dhe autoritetet përkatëse;
- b. bashkërendon luftën kundër manipulimit të garave sportive;
- c. merr, përqendron dhe analizon informacion mbi bastet e parregullta dhe të dyshimta që vihen mbi garat sportive që zhvillohen në territorin e Palës dhe, sipas rastit, nxjerr paralajmërime;
- d. transmeton informacion mbi shkeljet e mundshme të ligjeve ose rregulloreve sportive të përmendura në këtë Konventë tek autoritetet publike ose organizatat sportive dhe/ose operatorët e basteve sportive;
- e. bashkëpunon me të gjitha organizatat dhe autoritetet përkatëse në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë platformat kombëtare të Shteteve të tjera.

2. Secila Palë i komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës emrin dhe adresat e platformës kombëtare.

**Neni 14 - Mbrojtja e të dhënave personale**

1. Secila Palë miraton ato masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të siguruar që të gjitha veprimet ndaj manipulimit të garave sportive të përputhen me ligjet dhe standardet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave personale, veçanërisht në shkëmbimin e informacionit të mbuluar nga kjo Konventë.
2. Secila Palë miraton ato masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të garantuar që autoritetet dhe organizatat publike të mbuluara nga kjo Konventë të marrë masat e duhura me qëllim që të sigurojë që, nëse të dhënat personale mbledhen, përpunohen dhe shkëmbehen, pavarësisht nga natyra e këtyre shkëmbimeve, t'i kushtohet vëmendje e duhur parimeve të ligjshmërisë, përshtatshmërisë, përkatësisë dhe saktësisë dhe gjithashtu edhe sigurisë së të dhënave dhe të drejtave të subjekteve të të dhënave.
3. Secila Palë parashikon në ligjet e saj që autoritetet dhe organizatat publike të mbuluara nga kjo Konventë të sigurojnë të shkëmbimi i të dhënave për qëllimin e kësaj Konvente të mos shkojë më tej minimumit të nevojshëm për ndjekjen e qëllimit të deklaruar të shkëmbimit.
4. Secila Palë fton autoritetet dhe organizatat e ndryshme publike të mbuluara nga kjo Konventë të sigurojnë mjetet e duhura teknike për të garantuar sigurinë e të dhënave të shkëmbyera dhe të garantojnë besueshmërinë dhe integritetin e tyre, si dhe disponibilitetin dhe integritetin e sistemeve të shkëmbimit të të dhënave dhe identifikimin e përdoruesve të tyre.

**Kapitulli IV - Ligji penal lëndor dhe bashkëpunimi në lidhje me zbatimin****Neni 15 Veprat penale në lidhje me manipulimin e garave sportive**

1. Secila Palë garanton që ligjet e saj të brendshme të mundësojnë sanksionimin penal të manipulimit të garave sportive nëse ai përfshin praktika detyruese, të korruptuara ose mashtruese, sipas parashikimit në ligjin e brendshëm.

**Neni 16 - Pastrimi i të ardhurave nga veprat penale në lidhje me manipulimin e garave sportive**

1. Secila Palë miraton ato masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të parashikuar si vepra penale sipas ligjit të saj të brendshëm sjelljen siç përmendet në Nenin 9, paragrafët 1 dhe 2 të Konventës së Këshillit të Europës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi dhe mbi Financimin e Terrorizmit (2005, CETS Nr 198), në Nenin 6, paragrafi 1 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transkombëtar (2000) ose në Nenin 23, paragrafi 1 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (2003), sipas kushteve të përmendura atje, nëse vepra përkatëse që ka shkaktuar fitimin është një prej atyre të përmendura në Nenet 15 dhe 17 të kësaj Konvente dhe në çdo rast, nëse bëhet fjalë për shantazh, korrupsion dhe mashtrim.
2. Në vendimarrjen mbi gamën e veprave penale që konsiderohen si vepra penale përkatëse të përmendura në paragrafin 1, secila Palë mund të vendosë, në pajtim me ligjin e saj të brendshëm, se si ajo do t'i përkufizojë veprat penale dhe natyrën e çdo elementi të veçantë që i bën ato serioze.
3. Secila Palë shqyrton përfshirjen e manipulimit të garave sportive në kuadrin e saj të parandalimit të pastrimit të parave duke u kërkuar operatorëve të basteve sportive të zbatojnë kërkesat për kujdesin e duhur, regjistrimin dhe raportimin mbi klientët.

**Neni 17 - Mbështetja dhe ndihma**

1. Secila Palë miraton ato masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të parashikuar si vepra penale sipas ligjit të saj të brendshëm, nëse kryhen me qëllim, mbështetjen dhe ndihmën në kryerjen e veprave penale të përmendura në Nenin 15 të kësaj Konvente.

**Neni 18 - Përgjegjësia korporative**

1. Secila Palë miraton ato masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të siguruar që personat juridikë mund të mbahen përgjegjës për veprat penale të përmendura në Nenet 15 deri 17 të kësaj Konvente, të kryera për përfitimin e tyre nga çdo person fizik, duke vepruar individualisht ose si një anëtar i një organi të një personi juridik, i cili ka një pozicion drejtues brenda personit juridik, bazuar në:



- a. prokurën e një personi juridik;
  - b. autoritetin për të marrë vendime në emër të personit juridik;
  - c. autoritetin për të ushtruar kontroll brenda personit juridik.
2. Në pajtim me parimet ligjore të Palës, përgjegjësia e një personi juridik mund të jetë penale, civile ose administrative.
3. Përveç se në rastet e parashikuara tashmë në paragrafin 1, secila Palë merr masat e nevojshme për të siguruar që një person juridik mund të mbahet përgjegjës nëse mungesa e mbikëqyrjes ose kontrollit nga një person fizik i përmendur në paragrafin 1 ka bërë të mundur kryerjen e një veprë penale të përmendur në Nenet 15 deri 17 të kësaj Konvente në përfitim të atij personi juridik nga një person fizik që vepron nën autoritetin e tij.
4. Kjo përgjegjësi nuk cenon përgjegjësinë penale të personave fizikë të cilët kanë kryer veprën penale.

## **Kapitulli V - Juridiksioni, procedura penale dhe masat e ekzekutimit**

### **Neni 19 - Juridiksioni**

1. Secila Palë miraton ato masa legislative ose të tjera që mund të jenë të nevojshme për të parashikuar juridiksion mbi veprat penale të përmendura në Nenet 15 deri 17 të kësaj Konvente nëse kjo vepër kryhet:
- a. në territorin e saj; ose
  - b. në bordin e anijeve që kanë flamurin e saj; ose
  - c. në bordin e avionëve të regjistruar sipas ligjit të saj; ose
  - d. nga një prej shtetasve të saj ose nga një person që ka vendbanim të zakonshëm në territorin e saj.
2. Secili Shtet dhe Bashkimi European, në momentin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose aprovimit, me një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, deklaron që ai rezervon të drejtën për të mos zbatuar ose për të zbatuar vetëm në raste ose kushte specifike, rregullat për juridiksionin e parashikuara në paragrafin 1 të nënparagrafin d të këtij Neni.
3. Secila Palë merr masat e nevojshme legislative ose të tjera për të parashikuar juridiksionin mbi veprat penale të përmendura në Nenet 15 deri 17 të kësaj Konvente në rastet në të cilat një kundërvajtës i dyshuar është i pranishëm në territorin e saj dhe nuk mund të ekstradohet tek një Palë tjetër mbi bazën e shtetësisë së tij ose të saj.
4. Nëse më shumë se një Palë pretendon juridiksion mbi një vepër penale të dyshuar të përmendur në Nenet 15 deri 17 të kësaj Konvente, Palët e përfshira, sipas rastit, konsultohen me njëra-tjetrën me synim përcaktimin e juridiksionit më të përshtatshëm për qëllimet e ndjekjes penale.
5. Pa cenuar rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, kjo Konventë nuk përjashton asnjë juridiksion penal, civil dhe administrativ të ushtruar nga një Palë në pajtim me ligjin e saj të brendshëm.

### **Neni 20 - Masat për të siguruar prova elektronike**

1. Secila Palë miraton masa legislative dhe të tjera për të siguruar prova elektronike, ndërmjet të tjerash, nëpërmjet ruajtjes së përshpejtuar të të dhënave që gjenden në kompjuter, porositi e dhënies, kërkimit dhe sekuestrimit të të dhënave të ruajtura në kompjuter, mbledhjen e të fluksit të të dhënave në kohë reale dhe përgjimin e përmbajtjes së të dhënave, në pajtim me ligjin e saj të brendshëm, gjatë hetimit të veprave penale të përmendura në Nenet 15 deri 17 të kësaj Konvente.

### **Neni 21 - Masat e mbrojtjes**

1. Secila Palë shqyrton miratimin e atyre masave ligjore që mund të jenë të nevojshme për të siguruar mbrojtje të efektshme për:
- a. personat që japin, në mirëbesim dhe me shkaqe të arsyeshme, informacion në lidhje me veprat penale që kanë të bëjnë me Nenet 15 deri 17 të kësaj Konvente ose ndryshe bashkëpunojnë me autoritetet hetimore dhe të ndjekjes penale;
  - b. dëshmitarët që japin prova në lidhje me këto vepra penale;
  - c. nëse është e nevojshme, anëtarët e familjeve të personave të përmendur në nënparagrafin a dhe b.

## **Kapitulli VI - Sanksionet dhe masat**

### **Neni 22 - Sanksionet penale ndaj personave fizikë**

1. Secila Palë merr masat e nevojshme legjislative dhe të tjera për të siguruar që veprat penale të përmendura në Nenet 15 deri 17 të kësaj Konvente, nëse kryhen nga personat fizikë, të dënohen me sanksione të efektshme, proporcionale dhe parandalues, duke përfshirë sanksione monetare, duke marrë parasysh seriozitetin e veprave penale. Këto sanksione përfshijnë dënimet që kanë të bëjnë me heqje lirie që mund të jenë shkak për ekstradim, sipas përkufizimit në ligjin e brendshëm.

### **Neni 23 - Sanksionet penale ndaj personave juridikë**

1. Secila Palë merr masat e nevojshme legjislative ose të tjera për të siguruar që personat juridikë që mbahen përgjegjës në pajtim me Nenin 18 t'u nënshtrohen sanksioneve të efektshme, proporcionale dhe parandaluese, duke përfshirë sanksionet monetare dhe mundësisht masa të tjera si:

- a. një skualifikim i përkohshëm ose i përhershëm nga ushtrimi i aktivitetit tregtar;
- b. vendosja nën mbikëqyrje gjyqësore;
- c. urdhri gjyqësor i shpërbërjes.

### **Neni 24 - Sanksionet administrative**

1. Secila Palë, sipas rastit, miraton ato masa legjislative ose të tjera në lidhje me veprimet që janë të dënueshme sipas ligjit të brendshëm që mund të jenë të nevojshme për të dënuar shkeljet e parashikuara në pajtim me këtë Konventë nëpërmjet sanksioneve dhe masave efektive, proporcionale dhe parandaluese pas procedimeve të kryera nga autoritetet administrative, nëse vendimi mund të bëhet shkak për një gjykim para një gjykate kompetente.

2. Secila Palë siguron që të zbatohen masat administrative. Kjo mund të bëhet nga autoriteti rregullator i basteve dhe autoriteti ose autoritetet e tjerë përgjegjës, në pajtim me ligjin e brendshëm.

### **Neni 25 - Sekuestrimi dhe konfiskimi**

1. Secila Palë merr masat e nevojshme legjislative dhe të tjera, në pajtim me ligjin e saj të brendshëm, për të lejuar sekuestrimin dhe konfiskimin e:

- a. mallrave, dokumenteve ose instrumenteve të përdorura ose të synuara për t'u përdorur për kryerjen e veprave penale të përmendura në Nenet 15 deri 17 të kësaj Konvente.
- b. të ardhurat nga këto vepra penale, ose një pronë me vlerën që përputhet me këto të ardhura.

## **Kapitulli VII - Bashkëpunimi ndërkombëtar në çështjet gjyqësore dhe të tjera**

### **Neni 26 - Masat me synim bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale**

1. Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në pajtim me dispozitat e kësaj Konvente dhe në pajtim me instrumentet dhe masat përkatëse të zbatueshme ndërkombëtare dhe rajonale të rëna dakord mbi bazën e legjislacionit të njësuar dhe reciprok dhe me ligjin e tyre të brendshëm, në masën më të gjerë të mundshme për qëllimet e hetimit, ndjekjeve penale, dhe procedimeve gjyqësore në lidhje me veprat penale të përmendura në Nenet 15 - 17 të kësaj Konvente, duke përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin.

2. Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në masën më të gjerë të mundshme, në pajtim me traktatet përkatës të zbatueshëm ndërkombëtarë, rajonalë dhe dypalësh për ekstradimin dhe ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale dhe në pajtim me ligjin e tyre të brendshëm, në lidhje me veprat penale të përmendura në Nenet 15 deri 17 të kësaj Konvente.

3. Në çështjet e bashkëpunimit ndërkombëtar, kurdoherë që konsiderohet si kërkesë dënueshmëria penale nga të dy palët, ai konsiderohet të jetë përmbushur, pavarësisht nëse ligjet e Shtetit të kërkuar e futin veprën penale brenda të njëjtës kategori të veprave ose përdorin të njëjtin term për të përcaktuar veprën penale si Shteti kërkuar, nëse sjellja që përmban shkeljen në lidhje me të cilën kërkohet ndihmë e ndërsjellë ligjore ose ekstradimi është një vepër penale sipas ligjeve të të dy Palëve.

4. Nëse një Palë e cila e kushtëzon ekstradimin ose ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale me ekzistencën e një traktati merr një kërkesë për ekstradim ose ndihmë të ndërsjellë ligjore në çështjet penale nga një Palë me të cilën ajo nuk ka traktat të tillë, ajo, duke vepruar në pajtim të plotë me detyrimet e saj sipas së drejtës ndërkombëtare dh duke iu nënshtruar kushteve të parashikuara nga ligji i brendshëm, e konsideron Konventën të jetë baza ligjore për ekstradim ose ndihmë të ndërsjellë në çështjet ligjore në lidhje me veprat penale të përmendura në Nenet 15 deri 17 të kësaj Konvente.

#### **Neni 27 - Masa të tjera ndërkombëtare bashkëpunimi në lidhje me parandalimin**

1. Secila Palë përpiqet të integrojë, sipas rastit, parandalimin dhe luftën kundër manipulimit të garave sportive në programet e asistencës për përfitim të Shteteve të tretë.

#### **Neni 28 - Bashkëpunimi ndërkombëtar me organizatat sportive ndërkombëtare**

1. Secila Palë, në pajtim me ligjin e saj të brendshëm, bashkëpunon me organizatat sportive ndërkombëtare në luftën kundër manipulimit të garave sportive.

### **Kapitulli VIII - Veprimet pasuese**

#### **Neni 29 - Dhënia e informacionit**

1. Secila Palë i paraqet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, në një prej gjuhëve zyrtare të këshillit të Europës, të gjithë informacionin përkatës në lidhje me masat legislative dhe të tjera të marra prej saj me synim përputhjen me termat e Konventës.

#### **Neni 30 - Komiteti Pasues i Konventës**

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, Themelohet Komiteti Pasues i Konventës.

2. Secila Palë përfaqësohet në Komitetin Pasues të Konventës nga një ose më shumë delegatë, duke përfshirë përfaqësues të autoriteteve publike përgjegjës për sportin, zbatimin e ligjit dhe rregullimin e basteve. Secila Palë ka një votë.

3. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, si dhe komitetet e tjerë përkatës ndër-qeveritarë të Këshillit të Europës, cakton secili një përfaqësues tek Komiteti Pasues i Konventës me synim dhënien e kontributit për një qëndrim shumë-sektorial dhe shumë-disiplinor. Komiteti Pasues i Konventës, nëse është e nevojshme, mund të ftojë me vendim unanim, çdo Shtet që nuk është palë në Konventë, çdo organizatë ose organ ndërkombëtar, për t'u përfaqësuar me vëzhgues në mbledhjet e tij. Përfaqësimet e caktuara sipas këtij paragrafi marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit Pasues të Konventës pa të drejtë vote.

4. Mbledhjet e Komitetit Pasues të Konventës thirren nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës. Mbledhja e tij e parë mbahet sa më shpejt që të jetë normalisht e mundshme, dhe në çdo rast brenda një viti pas datës së hyrjes në fuqi të Konventës. Më vonë ai mbledhjet kurdoherë që të kërkohej nga të paktën një e treta e Palëve ose nga Sekretari i Përgjithshëm.

5. Në pajtim me dispozitat e kësaj Konvente, Komiteti Pasues i Konventës përpilon dhe miraton me konsensus rregullat e veta të procedurës.

6. Komiteti Pasues i Konventës asistohet nga Sekretariati i Këshillit të Europës në përmbushjen e funksioneve të tij.

#### **Neni 31 - Funksionet e Komitetit Pasues të Konventës**

1. Komiteti Pasues i Konventës është përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kësaj Konvente.

2. Komiteti Pasues i Konventës miraton dhe modifikon listën e organizatave sportive të përmendura në Nenin 3.2 duke siguruar që ajo të publikohet në një mënyrë të përshtatshme.

3. Komiteti Pasues i Konventës, veçanërisht, mund të:

a. bëjë rekomandime për Palët në lidhje me masat që duhet të merren për qëllimet e kësaj Konvente, veçanërisht në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar;

b. sipas rastit, bëjë rekomandime për Palët, pas publikimit të dokumentacionit shpjegues dhe, pas konsultimeve paraprake me përfaqësuesit e organizatave sportive dhe operatorët e basteve sportive, veçanërisht për:

- kriteret që duhet të përmbushen nga organizatat sportive dhe operatorët e basteve sportive me qëllim përfitimin nga shkëmbimi i informacionit të përmendur në Nenin 12.1 të kësaj Konvente;
- mënyra të tjera që synojnë përforcimin e bashkëpunimit operacional ndërmjet autoriteteve përkatëse publike, organizatave sportive dhe operatorëve të basteve, siç përmendet në Konventë;

c. mbajë organizatat ndërkombëtare përkatëse dhe publikun të informuar në lidhje me aktivitetet e ndërmarra brenda kuadrit të kësaj Konvente;

d. përgatisë një opinion për Komitetin e Ministrave mbi kërkesën e një Shteti jo-anëtar të Këshillit të Europës për t'u ftuar nga Komiteti i Ministrave të nënshkruajë Konventën në pajtim me Nenin 32.2.

4. Me synim përmbushjen e funksioneve të tij, Komiteti Pasues i Konventës, me iniciativë të vet, mund të organizojë mbledhje ekspertësh.

5. Komiteti Pasues i Konventës, me pëlqimin paraprak të Palëve të interesuara, organizon vizita tek Palët.

## **Kapitulli IX - Dispozita të fundit**

### **Neni 32 - Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës, Shtetet e tjera Palë në Konventën Kulturore Europiane, Bashkimin Europian dhe Shtetet jo-anëtare që kanë marrë pjesë në përpilimin e saj ose që janë statusin e vëzhguesit tek Këshilli i Europës.

2. Kjo Konventë është gjithashtu e hapur për nënshkrim nga çdo Shtet tjetër jo-anëtar i Këshillit të Europës me ftesë të Komitetit të Ministrave. Vendimi për të ftuar një Shtet jo-anëtar për të nënshkruar Konventën merret nga shumica e parashikuar në Nenin 20 d të Statutit të Këshillit të Europës dhe me votën unanime të përfaqësuesve të Shteteve Kontraktuese me të drejtë për të marrë pjesë në Komitetin e Ministrave, pas konsultimit me Komitetin pasues të Konventës, pas themelimit.

3. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

4. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prj tre muajsh pas datës në të cilën pesë nënshkruer, duke përfshirë të paktën tre Shtete Anëtare të Këshillit të Europës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'iu nënshtruar Konventës në pajtim me dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3.

5. Në lidhje me një Shtet nënshkruer ose Bashkimin Europian që shpreh më vonë pëlqimin e tij për t'iu nënshtruar asaj, Konventa hyn në fuqi në ditën e para të muajit pas skadimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së shprehjes së pëlqimit për t'iu nënshtruar Konventës në pajtim me dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3.

6. Një Palë Kontraktuese që nuk është anëtare e Këshillit të Europës kontribuon në financimin e Komitetit Pasues të Konventës në një mënyrë që vendoset nga Komiteti i Ministrave pas konsultimeve me atë Palë.

### **Neni 33 - Efektet e Konventës dhe raporti i saj me instrumentet e tjera ndërkombëtare**

1. Kjo Konventë nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e Palëve sipas konventave ndërkombëtare shumëpalëshe në lidhje me temat specifike. Veçanërisht, kjo Konventë nuk i ndryshon të drejtat dhe detyrimet e tyre që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera që janë lidhur më parë në lidhje me luftën kundër dopingut dhe në pajtim me objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente.

2. Kjo Konventë plotëson veçanërisht, sipas rastit, traktatet e zbatueshme shumëpalëshe ose dypalëshe ndërmjet Palëve, duke përfshirë dispozitat e:

- a. Konventën Europiane të Ekstradimit (1957, ETS Nr 24);
- b. Konventën Europiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale (1959, ETS Nr 30);
- c. Konventën për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi (1990, ETS Nr 141);
- d. Konventës së Këshillit Të Europës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga krimi dhe mbi Financimin e Terrorizmit (2005, CETS Nr 198).

3. Palët në Konventë mund të lidhin traktate dypalëshe ose shumëpalëshe me njëri-tjetrin për çështjet e trajtuara në këtë Konventë me synim plotësimin ose fuqizimin e tyre ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve të mishëruara në to.

4. Nëse dy ose më shumë Palë kanë lidhur tashmë një traktat për çështjet e trajtuara në këtë Konventë ose kanë vendosur ndryshe marrëdhënie në lidhje me këto çështje, ato kanë gjithashtu të drejtë të zbatojnë atë traktat ose të rregullojnë marrëdhëniet e tyre përkatësisht. Megjithatë, kur Palët vendosin marrëdhënie në lidhje me çështjet e trajtuara në këtë Konventë të ndryshme nga sa parashikohet në të, ato e bëjnë këtë në një mënyrë që nuk është në mospërputhje me objektivat dhe parimet e Konventës.

5. Asgjë në këtë Konventë nuk cenon të drejtat, kufizimet, detyrimet dhe përgjegjësitë e tjera të Palëve.

#### **Neni 34 - Kushtet dhe garancitë**

1. Secila palë siguron që vendosja dhe zbatimi i kompetencave dhe procedurave të parashikuara në Kapitujt II dhe VII t'u nënshtrohen kushteve dhe garancive të parashikuara në ligjin e saj të brendshëm, i cili parashikon mbrojtjen e përshtatshme të të drejtave dhe lirive të njeriut, duke përfshirë të drejtat që rrjedhin në pajtim me detyrimet që ajo ka ndërmarrë sipas Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Konventës Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara të vitit 1966 mbi të Drejtat Civile dhe Politike, dhe instrumente të tjera ndërkombëtare të zbatueshme për të drejtat e njeriut dhe që përfshin parimin e proporcionalitetit në ligjin e saj të brendshëm.

2. Këto kushte dhe garanci, sipas rastit duke patur parasysh natyrën e procedurës ose kompetencës përkatëse, *ndër të tjera*, përfshin mbikëqyrjen gjyqësore ose tjetër të pavarur, shkaqet që justifikojnë zbatimin, si dhe kufizimin e objektit dhe kohëzgjatjen e kësaj kompetence ose procedure.

3. Në masën që është në pajtim me interesin publik, veçanërisht administrimin e shëndoshë të drejtësisë, secila Palë konsideron ndikimin e kompetencave dhe procedurave në këta kapituj mbi të drejtat, përgjegjësitë dhe interesat legjitime të palëve të treta.

#### **Neni 35 - Zbatimi territorial**

1. Çdo Shtet ose Bashkimi European, në momentin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aprovimit, mund të specifikojë territorin ose territoret tek të cilët zbatohet kjo Konventë.

2. Secila Palë, në një datë të mëvonshme, nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente tek çdo territor tjetër i specifikuar në deklaratë dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit ajo është përgjegjëse ose në emër të të cilit autorizohet të marrë përsipër. Në lidhje me këtë territor Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje me çdo territor të specifikuar në këtë deklaratë, mund të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

#### **Neni 36 - Klauzola federale**

1. Një Shtet federal mund të rezervojë të drejtën të marrë përsipër detyrimet sipas Kapitujve II, IV, V dhe VI të kësaj Konvente në pajtim me parimet e saj themelore që rregullojnë marrëdhënien ndërmjet qeverisë qendrore dhe Shteteve përbërës ose njërive të ngjashme territoriale, me kusht që të vazhdojë të jetë në gjendje të bashkëpunojë sipas Kapitujve III dhe VII.

2. Nëse bëhet një rezervë sipas paragrafit 1, një Shtet federal nuk mund të zbatojë termat e kësaj rezerve për të përjashtuar ose ulur në mënyrë thelbësore detyrimet e tij për marrjen e masave të parashikuara në Kapitujt III dhe VII. Në tërësi, ai parashikon një kapacitet të gjerë dhe të efektshëm ekzekutimi në lidhje me ato masa.

3. Në lidhje me dispozitat e kësaj Konvente, zbatimi i të cilave futet në juridiksionin e çdo Shteti përbërës ose njësi të tjera të ngjashme territoriale, që nuk janë të detyruara nga sistemet kushtetuese të federatës të marrin masa legislative, qeveria federale njofton autoritetet kompetente të këtyre Shteteve për këto dispozita me mendimin e saj të favorshëm, duke i inkurajuar ata të ndërmarrin hapat e duhur për t'u dhënë atyre fuqi.

### **Neni 37 - Rezervat**

1. Me një njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, çdo Shtet ose Bashkimi Europian, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose aprovimit, mund të deklarojë që ai shfrytëzon rezervat e parashikuara në Nenin 19, paragrafi 2 dhe në Nenin 36, paragrafi 1. Asnjë rezervë tjetër nuk mund të bëhet.

2. Një Palë që ka bërë një rezervë në pajtim me paragrafin 1 mund ta tërheqë plotësisht ose pjesërisht nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Kjo tërheqje hyn në fuqi në datën e marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm. Nëse njoftimi deklaron që tërheqja e një rezerve hyn në fuqi në një datë të specifikuar në të dhe kjo datë është një datë më e mëvonshme se data në të cilën njoftimit merret nga Sekretari i Përgjithshëm, tërheqja hyn në fuqi në atë datë të mëvonshme.

3. Një Palë që ka bërë një rezervë e tërheq këtë rezervë, plotësisht ose pjesërisht, menjëherë sapo ta lejojnë rrethanat.

4. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës mund t'u kërkojë periodikisht Palëve që janë bërë një ose më shumë rezerva për hollësi në lidhje me mundësinë e tërheqjes së këtyre rezervave.

### **Neni 38 - Ndryshimet**

1. Ndryshimet e Neneve të kësaj Konvente mund të propozohen nga çdo Palë, Komiteti Pasues i Konventës ose Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës.

2. Çdo propozim për një ndryshim i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe prej tij ose asaj i kalohet Palëve, Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës, Shteteve jo-anëtare që kanë marrë pjesë në përpilimin e kësaj Konvente ose që kanë statusin e vëzhguesit tek Këshilli i Europës, Bashkimit Europian, çdo Shtet që është ftuar për të nënshkruar këtë Konventë dhe Komitetit Pasues të Konventës të paktën dy muaj para mbledhjes në të cilën do të shqyrtohet. Komiteti Pasues i Konventës i paraqet Komitetit të Ministrave mendimin e tij mbi ndryshimin e propozuar.

3. Komiteti i Ministrave e shqyrton ndryshimin e propozuar dhe çdo mendim të paraqitur nga Komiteti Pasues i Konventës dhe mund të miratojë ndryshimin me shumicën e parashikuar në Nenin 20 d të Statutit të Këshillit të Europës.

4. Teksti i çdo ndryshimi të miratuar nga Komiteti i Ministrave në pajtim me paragrafin 3 të këtij Neni u paraqitet Palëve për pranim.

5. Çdo ndryshim i miratuar në pajtim me paragrafin 3 të këtij Neni hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej një muaji pasi të gjithë palët të kenë informuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e tyre pas procedurave të tyre përkatëse të brendshme.

6. Nëse një ndryshim është miratuar nga Komiteti i Ministrave, por nuk ka hyrë në fuqi në pajtim me paragrafin 5, një Shtet ose Bashkimi Europian nuk mund të shprehë pëlqimin e tij për t'iu nënshtruar Konventës pa pranuar në të njëjtën kohë edhe ndryshimin.

### **Neni 39 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Komiteti Pasues i Konventës, në bashkëpunim të ngushtë me komitetet përkatës ndër-qeveritare të Këshillit të Europës, mbahet i informuar për çdo vështirësi në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Konvente.

2. Në rastin e mosmarrëveshjes ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, ata kërkojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes nëpërmjet bisedimeve, pajtimit ose arbitrazhit, ose një mjet tjetër paqësor të zgjedhjes së tyre.

3. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të vendosë procedura zgjidhjeje që mund të përdoren nga palët në një mosmarrëveshje, sipas vullnetit të tyre.

#### **Neni 40 - Denoncimi**

1. Secila palë mund të denoncojë në çdo kohë këtë Konventë nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Ky denoncim hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

#### **Neni 41 - Njoftimi**

1. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton Palët, Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës, Shtetet e tjerë Palë në Konventën Kulturore Europiane, Shtetet jo-anëtare që kanë marrë pjesë në përpilimin e kësaj Konvente ose që kanë statusin e vëzhguesit tek Këshilli i Europës, Bashkimin European dhe çdo Shtet që është ftuar për të nënshkruar këtë Konventë në pajtim me dispozitat e Nenit 32 për:

- a. çdo nënshkrim;
- b. depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi ose aprovimi;
- c. çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në pajtim me Nenin 32;
- d. çdo rezervë dhe çdo tërheqje të një rezerve të bërë në pajtim me Nenin 37;
- e. çdo deklaratë të bërë në pajtim me Nenet 9 dhe 13;
- f. çdo veprim, njoftim ose komunikim tjetër në lidhje me këtë Konventë.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në \_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_ 201., në anglisht dhe frëngjisht, ku të dy tekstet janë njëjloj autentikë, në një kopje të vetme që depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës u transmeton kopje të certifikuara Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës, Shteteve jo-anëtare që kanë marrë pjesë në përpilimin e kësaj Konvente ose që kanë statusin e vëzhguesit tek Këshilli i Europës, Bashkimit European dhe çdo Shteti që është ftuar për të nënshkruar këtë Konventë